









UNIVERSITETI “FAN S. NOLI”, KORÇË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM**

**VITI AKADEMIK 2022-2023**

**(Përmbledhje e rekomandimeve nga raportet e katër fakulteteve)**

**NJSBC :**

Dr. Aldona Minga	Anëtar	Firma 
Dr. Eris Rusi	Anëtar	Firma 
Dr. Aida Mosko	Anëtar	Firma 
Dr. Maria Dojçe	Anëtar	Firma 
Dr. Evis Kapurani	Anëtar	Firma 
Msc. Xhovan Saraçi	Anëtar	Firma 
Edona Kolludra	(Studente)	

## PARIMET E PUNËS SË NJSBC

- Vlerësimi i Cilësisë duhet të karakterizohet nga profesionalizmi, vërtetësia, objektiviteti, paanshmëria, transparenca e plotë dhe përfshirja e të gjithë aktorëve në të gjitha fazat e vlerësimit.
- Zhvillimi i Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (SBSC) në Njësitë e IAL realizojnë vlerësimin e brendshëm me synimin që të krijohet një pamje e qartë dhe transparente e njësisë nën vlerësim, për të ndërtuar politika zhvillimi në përputhje me misionin e saj dhe të shërbejë si bazë për procesin e mëtejshëm të akreditimit të IAL-së dhe të programeve të studimit.
- Të bëjë publik informacionin me qëllim që të gjithë partnerët dhe publiku i gjerë (studentët, prindërit, stafet akademike dhe ndihmëse, partnerët e tjerë socialë, ekonomikë e politikë) të informohen për gjendjen e njësisë, programeve, kurrikulave, shërbimeve, etj.
- Të shërbejë për kultivimin e Kulturës së Cilësisë në IAL si pjesë e brendshme dhe e qëndrueshme.
- Vlerësimi të bëhet i mbështetur në dokumente, procedura, anketime, takime me palët e interesuara etj.

## HYRJE

Ky raport prezanton rezultatet e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programeve profesionale, referuar Nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikime, programeve të ciklit të parë të studimit “Bachelor” dhe programeve të ciklit të dytë “Master” në Universitetin “Fan S. Noli” në Korçë, kryer nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm.

Qëllimi i këtij procesi është që të sigurojë një vlerësim korrekt, të bazuar në tregues realë dhe të matshëm të nivelit të arritjes së standardeve dhe garantimit të cilësisë së programit të studimit të përfshirë në vlerësim, të përgatisë një raport i cili do të shërbejë si bazë për grupin e vlerësimit të jashtëm, gjatë procesit të akreditimit.

Për të përmbushur me sukses këtë qëllim, NJSBC është bërë pjesë e trajnimeve paraprake të organizuara nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Universitetit, mbi bazën e përvojës së vlerësimeve të mëparshme, duke hartuar edhe një plan pune, duke ndarë detyrat dhe duke udhëzuar NJSBC për përmbushjen e detyrave.

Për hartimin e këtij raporti, NJSBC ka mbajtur parasysh raportin e viteve të kaluara, si dhe raportin e GVJ që është realizuar në kuadër të akreditimit institucional.

Gjithashtu u shfytëzuan të gjitha materialet, të dhënat e Fakultetit, vlerësimet e kryera nga studentët për procesin mësimor, për stafin akademik, për infrastrukturën. Dokumentacioni bazë, mbi të cilin u mbështet procesi i Vlerësimit të Brendshëm:

- Ligj nr. 80/2015, për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë
- Standardet shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimeve
- Udhëzimet e MASR-së
- Dokumente të veprimtarisë institucionale të Universitetit “Fan S. Noli”, më konkretisht:
  - Statuti i UK-së,

- Rregullore e UK-së,
- Rregulloret e fakulteteve
- Rregulloret e Programeve të studimit
- Rregullore e transferimeve
- Planet mësimore - Formularët e ngarkesës vjetore të stafit

## **PËRSHKRIMI I UNIKO**

Aktualisht UNIKO përbëhet nga katër fakultete, përkatësisht Fakulteti i Bujqësisë, Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë dhe Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane. Fakultetet janë të organizuara në 15 departamente.

Në universitet funksionon “Qendra për Formimin e Vazhduar”, si njësi bazë kërkimore, trajnuese dhe strukturë e formimit të vazhduar, misioni i të cilës është trajnimi i mësuesve në detyrë. Njësi e Fakultetit të Bujqësisë është edhe Ekonomia Didaktike Eksperimentale (më tej, EDE) e cila ofron infrastrukturë për kërkim shkencor dhe praktikën profesionale të programeve të studimit të këtij fakulteti.

Studimet në UNIKO janë organizuar në cikle, duke përmbushur kështu kriteret e parashtruara në Deklaratën e Bolonjës. Ai ofron 7 programe studimi të karakterit profesional 2-vjeçar (120 kredite), 25 programe të ciklit të parë (180 kredite), 13 programe të ciklit të dytë master profesional (60 kredite), 8 programe të ciklit të dytë master profesional (120 kredite), 3 programe Master i Shkencave (120 kredite) dhe 1 program të ciklit të tretë / PhD. Aktualisht në kuadër projekti UNIKO ka nënshkruar marrëveshjen për hapjen e programit të përbashkët të doktoratës “Mjekësi e bimëve në hortikulturë të qëndrueshme” Numri aktual i studentëve në këto programe është 2930.

Universiteti ka 154 pedagogë me kohë të plotë, 51 personel ndihmësakademik me karakter administrativ, 11 personel ndihmësakademik me karakter mësimor dhe 27 punonjës shërbimi. I gjithë stafi angazhohet në rritjen e nivelit të mësimdhënies, të të nxënit dhe të shërbimeve infrastrukturore që ky institucion ofron. 75% e stafit akademik është i kualifikuar me tituj akademikë dhe grada shkencore, 20% prej tyre janë duke përfunduar studimet e tyre të doktoratës. Personeli akademik e promovon vazhdimisht kërkimin e tij shkencor në aktivitete shkencore rajonale, kombëtare, mbarëkombëtare dhe ndërkombëtare. Ai ka formuar tashmë një bibliografi të pasur botimesh në revista të rëndësishme shkencore. "Buletini Shkencor", një botim i indeksuar i UNIKO që prej vitit 1996, e ka përmirësuar vazhdimisht cilësinë e hulumtimit dhe publikimit të rezultateve me vlera të qëndrueshme shkencore. Buletini botohet në dy seri: në Serinë e Shkencave të Aplikuara dhe Serinë e Shkencave Sociale.

UNIKO është partner në disa projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, fokusi kryesor i të cilave ka qenë jo vetëm shkëmbimi i përvojave akademike nëpërmjet mobilitetit të stafit dhe studentëve, por edhe përmirësimi i cilësisë së programeve të studimit, i formave të mësimdhënies dhe të nxënit si dhe infrastrukturës në dispozicion të tyre.

Në vitin akademik 2016-2017 UNIKO aplikoi dhe përfundoi me sukses procesin e Akreditimit të Parë Institucional nga Agjencia Britanike e Akreditimit. Bazuar në VBA nr. 65, datë 21.09.2017 “Për akreditimin institucional të Universitetit “Fan S. Noli” ” periudha e vlefshmërisë së akreditimit institucional është 30.09.2022. Ajo shërbeu si praktikë e dobishme për përmirësimin e mësimdhënies dhe të nxënit, si dhe përcaktimin e drejtimeve të kërkimit

shkencor sipas rekomandimit të vetëm të lënë pas akreditimit institucional për “*hartimin dhe zbatimin e strategjisë në mbështetje të zhvillimit sistematik të fushave të kërkimit të identifikuar si prioritare në Planin e Zhvillimit Strategjik*”. UNIKO e ofroi atë duke i adresuar çështjet e kërkimit në planin e zhvillimit strategjik 2016-2020 dhe në planin strategjik të zhvillimit 2022-2027. Ai gjithashtu, përcaktoi fushat e kërkimit për çdo njësi kryesore dhe njësi bazë duke bazuar mbi to kërkimin shkencor.

UNIKO është vazhdimisht në kërkim të mjeteve dhe mënyrave për të promovuar kontekstin e duhur të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor për edukimin qytetarëve të ardhshëm dhe profesionistëve të kualifikuar që do të mundësojnë integrimin e vendit tonë në një kontekst më të gjerë vlerash evropiane.

### ***Misioni dhe objektivat***

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë në gjithë veprimtarinë e tij ka për mision kryesor të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor,

- të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend;
- të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal;
- të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit; të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor, si dhe të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë.

Nëpërmjet këtij raporti NJSBC do të evidentojë përmbushjen e standardeve të cilësisë për të gjitha fushat e vprimtarisë së UNIKO. Informacioni dhe të dhënat që do të nxirren nëpërmjet këtij raporti do të shërbejnë si indikatorë për përmirësimin e veprimtarisë së njërive kryesore dhe atyre bazë në UNIKO, si dhe do të vendosen në dispozicion të proceseve të vlerësimit të jashtëm institucional ose të programeve të studimit.

### ***Synimet e programeve të studimit***

Të gjitha programet e studimit janë hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit. Objektivat e tyre përfshijnë kualifikimet e parashikuara në planin strategjik dhe oferta e tyre akademike përputhet me kompetencën që synohet të përftohet në përfundim të tyre, duke përfshirë përgatitjen e specialistëve të aftë për tregun e punës.

Rregulloret e programeve të studimit japin informacion në lidhje me rezultatet e të nxënit, mundësitë për punësim apo mundësitë për të ndjekur studime të mëtejshme në cikle më të larta. Programet mësimore pasqyrojnë njohuritë e përvetësuara dhe rezultatet e të nxënit të lëndëve, të cilat janë hartuar për të plotësuar kornizën e kompetencave të programit të studimit si dhe titullin e diplomës.

Të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë i përfshijnë studentët në praktikë profesionale. Disa programe “Bachelor” ofrojnë, gjithashtu, periudha më të shkurtra praktike, në mënyrë që të përforcojnë fitimin e kompetencave profesionale nga ana e studentëve. Kurrikulat e

programeve të studimit janë hartuar me bazë kompetencat edhe sipas përcaktimeve të akteve nënligjore.

### ***Programet e studimit që ofron UNIKO gjenden në shtojcën 1.***

#### ***Objektivat e përgjithshme***

Rregulloret e programeve të studimeve janë të pajisura me informacion të përditësuar në lidhje me kurrikulën, planin mësimor, kategorizimin e disiplinës, kreditet përkatëse dhe ngarkesën mësimdhënëse/ të të nxënit, mundësitë e punësimit, kriteret e pranimit, procedurat e diplomimit, rregullat e pjesëmarrjes dhe format e vlerësimit, infrastruktura në dispozicion dhe programe të detajuara lëndore. Objektivat klasifikohen si “të përgjithshme”, në referencë të formimit të përgjithshëm të programit të studimit dhe “specifike”, duke paraqitur rezultatet e të nxënit dhe kompetencat që fitohen.

Të gjitha këto u bëhen të ditura studentëve nëpërmjet përshkrimit të shkurtër të objektivave dhe menaxhimit të përgjithshëm të programit të studimit, gjatë javës së parë të studimeve të tyre. Pjesë të përmbajtjes së programit paraqiten edhe në stendat e holleve të fakulteteve. Plani mësimor dhe elementet përkatëse, sipas kurseve, pasqyrohen edhe në faqen e internetit. Në fillim të lëndës/modulit, pedagogu bën të ditura objektivat e saj, format e studimit, rezultatet e të nxënit, zërat e vlerësimit të vazhduar, mënyrën e zhvillimit të provimit dhe vlerësimit të tij, detyrimet e studentëve për frekuentimin dhe çdo element tjetër që lidhet me zhvillimin e lëndës. Sistemi digjital i ruajtjes së të dhënave siguron informacion të plotë në lidhje me kurrikulat dhe elementet e tyre përbërëse. Në llogarinë personale, studenti gjen detaje (në shqip dhe në anglisht) në lidhje me secilën disiplinë.

Për çdo pyetje tjetër apo paqartësi, studentët mund t’u drejtohen përgjegjësve të njësive përkatëse, punonjësve të zyrave të informacionit dhe sekretarive të departamenteve.

**FAKULTETI I EKONOMISË**

***Konstatime, problematika dhe rekomandime:***

1. Mendohet që forcimi i lidhjeve të fakultetit me bizneset do të ndihmonte në mënyrë thelbësore në përmirësim të mëtejshëm të programeve dhe përshtatje më të mirë të tyre me nevojat e tregut. ***Gjetja e një gjuhe të përbashkët komunikimi midis punëdhënësve dhe të diplomuarve (punëkërkuësve) bazuar tek aftësitë, ku roli i institucionit tonë si koordinues dhe udhërrëfyes konsiderohet përcaktues në këtë komunikim, mendohet si emergjente.*** Kjo kërkon një hartim dhe specifikim shumë të detajuar të programeve mësimore sipas aftësive.
2. Synohet motivim dhe stimulim më i madh i stafit akademik, me pjesëmarrjen dhe të studentëve, për realizimin e artikujve shkencorë cilësorë.
3. Synohet ngritja e sinergjive me ekspertë të fushave të ndryshme, të departamenteve të ndryshme (jo vetëm nga FE), për studimin më efektiv të fenomeneve komplekse, sidomos për fushat prioritare të rajonit. Shikohet si emergjent, përmirësimi i infrastrukturës kërkimore të fakultetit.
4. Për vitin akademik 2022-2023, anëtarë të stafit akademik kanë aplikuar në disa projekte të kërkimit shkencor, për financim. Kanë rezultuar dy aplikime të fituara, sipas tabelës 4, të fokusuara tek problematika të natyrës ekonomiko-financiare të rajonit. Ndërkohë, pjesë e stafit akademik të fakultetit ka qënë pjesë e fokus grup, në kuadër të një projekti ku Universiteti Fan S. Noli merr pjesë, në funksion të rritjes së kapaciteteve lidhur me politikat e strategjive smart dhe smart cities. Trajnimet e një pjese të stafit do të ndihmojnë dhe në ngritjen e një qendre të mirëfilltë kërkimore, innovative në ambjentet e fakultetit të Ekonomisë
5. Vihet re një rënie e numrit të regjistrimeve në disa prej programeve kryesore, që fakulteti tradicionalisht ka ofruar. Pjesërisht, kjo rënie shpjegohet me probleme të ashpra që po kalon qarku ynë sidomos vitet e fundit, kryesisht të natyrës socio-ekonomiko-demografike, si dhe të një perspektive jo shpresëlënëse lidhur me punësimin dhe jo vetëm, të perceptuar nga të rinjtë e rajonit tonë.
6. Vihet re se një pjesë e studentëve orientohen drejt programeve të reja të hapura në të dy ciklet e studimit, të cilat mendohet se lehtësojnë punësimin e të diplomuarve, sepse duken më të orientuara ndaj nevojave më akute të tregut të punës dhe përshtaten më mirë me natyrën digjitale të të rinjve të sotëm (Informatikë Biznesi, Marketingu Digjital). Kjo, së bashku dhe me hapjen e programit profesional 2-vjeçar, kanë ndikuar së tepërmi në zbutjen e problemit me numrin e të regjistruarve dhe të diplomuarve.
7. Shqetësuese duket rënia sasiore dhe cilësore e studentëve në programet e Manaxhimit dhe Turizmit. Tryeza të rrumbullakta, diskutime periodike me pjesëmarrjen e shumë aktorëve dhe nën dritën e një informacioni të detajuar, janë emergjente, për t'i dhënë zgjidhje kësaj problematike shqetësuese.
8. Pavarësisht se nuk është përmendur më sipër, një model statistikor me karakteristika të mira psikometrike, i ndërtuar mbi bazën e të dhënave të nxënësve të shkollave të mesme të qarkut, lidhur me ndikimin e burimeve të informacionit në përzehjen e profilit studimor, parashikoi se burimet më të rëndësishme të informacionit, prej të cilave ndikohen nxënësit pritet të jenë aktivitetet e ndryshme të institucionit dhe promovimi i tyre kryesisht në rrjetet

sociale. Kjo gjetje është mirë që të merret në konsideratë gjatë përpilimit të strategjisë promovuese të institucionit.

### **Masat që duhet të ndërmerren:**

- Gjetjet e disa studimeve të realizuara nga Dekanati, të cilat konfirmojnë njëra-tjetrën, rekomandojnë fillimin e fushatës promovuese sa më parë (mundësisht në muajin nëntor të çdo viti akademik). Kjo fushatë duhet të jetë e mirëkoordinuar dhe e mirëpromovuar, sidomos në faqet Eëb të institucionit dhe në rrjetet sociale. Një gjë e tillë mendohet të ndikojë gradualisht në nivelin sasior dhe cilësor të prurjeve të reja.
- Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies, nëpërmjet përdorimit të teknikave të reja, përditësimit të materialeve dhe pasurimit me shembuj nga praktika.
- Nxitja e studentëve për të realizuar detyrat dhe projektet e përcaktuara në vlerësimin e vazhduar të çdo lënde.
- Gjetja e rrugëve për ndryshimin e mentalitetit fiks dhe të motivimit të ulët të një pjese të madhe të studentëve
- Të rritet pjesëmarrja e studentëve në projekte, konferenca studentore, tryeza të rumbullakëta, si mënyra motivuese për studentët.
- Institucioni duhet të gjejë urat e duhura të komunikimit me bizneset, duke u orientuar tek biznese të drejtuara nga individë largpamës, me strategji të mirëpërcaktuara, në funksion të përmirësimit të programeve mësimore të ofruara, praktikave mësimore, punës kërkimore-shkencore dhe të bashkëpunimeve frytëdhënëse për të ardhmen.
- Përfshirja e studentëve në studime kërkimore të realizuar nga anëtarët e departamentit.
- Krijimi i një baze të dhënash për ruajtjen e lidhjeve me studentët e diplomuar.
- Vendosja e lidhjeve të qëndrueshme me bizneset dhe institucionet për të orjentuar studentët e diplomuar drejt pozicioneve të kërkuara të punës.
- Orientimi i procesit të mësimnxënies bazuar në kompetencat.
- Duhet menduar dhe diskutuar se si gjuha e aftësive të jetë gjuha e përbashkët në komunikimin midis punëdhënësve dhe punëmarrësve, ku roli i fakultetit tonë në këtë bashkëpunim duhet të jetë përcaktues.
- Gjetja e mundësive nga fakulteti në bashkëpunim me rektoratin dhe aktorë të tjerë, për fuqizimin e infrastrukturës së fakultetit (pajisje kompjuterike, softuerike etj.), në funksion të punës kërkimore-shkencore dhe të mësimdhënies.

## **ANALIZA SWOT**

### **Pikat e forta të institucionit**

1. Rritja e përpjekjeve të stafit për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.
2. Realizimi i studimit të tregut me qëllim: (i) hapjen e programeve të reja (ii) rivlerësimin e kurrikulave (iii) riorganizimin e programeve egzistuese të studimit (iv) testimin e ecurisë të programeve të studimit (v) gjykimin e nevojave të maturantëve.
3. Realizimi me sukses i procesit të vetëvlerësimit të disa programeve. Përdorimi i përvojës të fituar si nxitje në drejtim të rritjes të cilësisë edhe në programet e tjera të ofruara.

4. Përdorimi me efektivitet i metodave inovative të mësimdhënies. Proçesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies ka qënë interaktiv dhe ka stimuluar eksplorimin e dijes, nëpërmjet diskutimit, aplikimit dhe veprimit duke u përdorur *metodat praktike* dhe ato *eksploruese*.
5. Angazhimi maksimal i stafit dhe studentëve në procesin e vetë-vlerësimit të disa programeve të studimit.
6. Konsolidimi i programeve të studimit që ofrohen nga tre departamentet e fakultetit.

### **Pika të dobta**

1. Mos plotësim i kuotave të miratuara.
2. Cilësi e pamjaftueshme e prurjeve të reja
3. Pjesëmarrje e ulët në projekte, pavarësisht disa sinjaleve inkurajuese.
4. Angazhim i ulët i stafit dhe studentëve në veprimtaritë kërkimore-shkencore
5. Përvetësim në nivel mesatar i dijeve teorike të studentëve.
6. Mungesa e një gjuhe të përbashkët në komunikimin e fakultetit me bizneset, sidomos në sektorin turistik.
7. Konfuzion në gjetjen e rrugëve të duhura lidhur me praktikatat e studentëve.

### **Mundësitë**

- Eksperienca dhe kualifikimet e stafit akademik rrit mundësinë për të aplikuar dhe bërë pjesë e projekteve të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare prej të cilave mund të përfitojnë direkt dhe/ose indirekt studentët.
- Shanse për rritjen e bashkëpunimit të Fakultetit me biznesin rajonal.
- Kthimi i fakultetit në një qendër trajnimi me njohuri ekonomike në rajonin juglindor të vendit.
- Pozita e favorshme gjeografike e rajonit për tërheqjen e studentëve edhe nga vendet kufitare për programe të ndryshme studimi.
- Mundësi punësimi si rezultat i rritjes të kërkesës të tregut për profesionin e ekonomistit.

### **Pengesat**

- Hapje të programeve të reja në njësitë e tjera kryesore të Universitetit
- Hapja e programeve të reja në Universitetet e tjera
- Faktorët demografikë të cilët projektojnë në të ardhmen një vijim të rënies së numrit të nxënësve të regjistruar në arsimin parauniversitar.
- Vështirësi në rekrutimin e një stafi të kualifikuar
- Vendimmarrje e centralizuar



## FAKULTETI I BUJQËSISË

### *Konstatime, problematika dhe rekomandime:*

1. Megjithëse është bërë një punë e mirë në drejtim të përmirësimit të performancës në shumë tregues të veprimtarisë akademike, prurjet në të tre programet e studimit rezultuan jo të kënaqshme krahasuar me vitin para ardhës.
2. Qendra e Karrierës dhe Alumni, UNIKO, duhet të bëjë më shumë përsa i takon lidhjes së studentëve me tregun e punës dhe kjo jo vetëm për studentët e diplomuar e punësuar në rajonin e Korçës, por edhe ata të rajoneve të tjera.
3. Konstatojmë se programet e studimit që ofron FB-is janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UNIKO 2022-2027 dhe kërkesat e tregut të punës për specialistë të aftë në këtë fushë. Duhet që të kenë një përfshirje aktive duke e konsideruar si një proces të vazhdueshëm dhe dinamik në studimin e tregut të punës dhe bashkëpunimi me institucionet rajonale që kanë lidhje të drejtpërdrejta me punësimin.
4. Cdo vit akademik NJSBC ben vlerësimin e veprimtarisë akademike me ane të pyetsoreve. Kete vit eshte vene re nje numer i ulet i plotesimit te ketyre pyetsoreve nga ana e studenteve te Fakultetit te Bujqesise.
5. Programi i studimit është objekt rishikimi periodik. Rishikimi bëhet para fillimit të vitit të ri akademik dhe synon të korrigjojë problemet që janë ndeshur gjatë procesit mësimor. FB, në fund të çdo viti akademik, organizon takime periodike për rishikimin e programeve të studimit dhe rregullores mësimore të tij. Zv. Rektori për mësimin i UNIKO në bashkëpunim me Drejtorinë e Kurrikules dhe Vlerësimit Institucional (DKVI) dhe përgjegjësat e njësive bazë, organizojnë takime pune periodike për rishikimin e programeve të studimit dhe rregulloreve të tyre. Programet e lëndëve/moduleve janë në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm në bazë të konkluzioneve studimore të tregut të punës (konform edhe të strategjisë të studimit të tregut të punës) duke konsideruar edhe opinionet apo propozimet e studentëve, të përfutuara nga anketat/pyetësorët, bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës e duke u bazuar në literaturë të përditësuar.
6. Në Fakultetin e Bujqësisë vëmë re një përpjekje serioze për të ngritur një sistem të përzgjedhjes së personelit akademik bazuar mbi kritere transparente dhe të meritokracisë. Rëndësi e veçantë i kushtohet edhe vlerësimit të performancës së personelit akademik, si në aspektin e mësimdhënies, ashtu edhe sa i përket veprimtarisë kërkimore shkencore dhe kualifikimit të mëtejshëm. Këta elementë janë pjesë e kontratës së pedagogut.
7. GVB vlerëson se shërbimi i kujdesit ndaj studentit shtrihet nga momenti i regjistrimit të studentit e deri në diplomimin e tij. Krahas këshillimit që ofrohet nga personeli akademik përmes këshillimit akademik, studenti në FB mund t'i drejtohet edhe Qendrës së Karrierës dhe Alumni, për të marrë informacion dhe këshillim akademik për procesin mësimor dhe aktivitetet studentore brenda e jashtë FB/UNIKO-së. Vëmendje e veçantë i kushtohet mendimit dhe kërkesave të studentëve ekselentë, me të cilët janë zhvilluar vazhdimisht fokus grupe për të marrë informacion në lidhje me aspektet që kanë nevojë të përmirësohen

8. Infrastruktura që është në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor plotëson standardet dhe kriteret e cilësisë. Godinat është e rikonstruktuar dhe mobiluar, me sistem ngrohjeje qëndore në dimer dhe një pjesë e mjediseve (zyrave) edhe me system ftohjeje si dhe system internet me kabëll dhe wireless. Mjediset e leksioneve dhe seminareve kanë siguruar një hapësirë të madhe për studentët. Në mjediset e leksioneve studion një numër maksimal prej 80-120, ndërsa për një sallë seminaresh është përcaktuar një numër maksimal prej 25 studentësh. Pra, parë në këndvështrimin praktik, përmes këtij kapaciteti, studentit i krijohet një mjedis komod dhe i mjaftueshëm për ndjekjen e procesit të mësimdhënies.
9. Studentët gëzojnë akses të plotë me internetin, cilësia e të cilit është e lartë. Çdo sallë mësimore është e pajisur me projektor. Laboratorët janë të pajisura me pajisjet e nevojshme të përcaktuara në programin mësimor. Gjithashtu edhe biblioteka funksionon dhe ofron kushte të mira dhe një fond të pasur botimesh elektronike, në gjuhën shqip dhe gjuhë të huaja, për të mbështetur studentët dhe personelin akademik në punën e tyre studimore dhe kërkimore shkencore. Personeli akademik i brendshëm është i akomoduar në departamente. Përgjigjësit e departamenteve janë akomoduar në zyra dyshe, Dekani është akomoduar në zyrë individuale.
10. GVB vëren se FB ka krijuar lidhje të qëndrueshme me një mjaft institucione të administratës publike që janë palë interesi për programet që ofron për të lehtësuar procesin e praktikave profesionale të studentëve, si edhe punësimin e ardhshëm të tyre. Kë këtë kuadër, UNIKO zhvillon çdo vit edhe Panairin e Punës, pjesë e të cilit është dhe FB, për të lehtësuar kontaktin e studentëve me kompani nga më të rëndësishmet në Shqipëri, me synim punësimin e mundshëm të studentëve në to. Edhe periudha kohore e zhvillimit të Panairit të Punës, përkon pikërisht me fundin e vitit akademik për të krijuar sa më shumë mundësi për studentët në prag diplomimi.
11. Në këtë çështje do të bëhet një përmbledhje e përgjithshme e përmbushjes së standardeve dhe evidentimit të çështjeve për përmirësim duke përfshirë edhe rekomandime/afate dhe plane veprimi për përmbushjen e tyre në vazhdim (në bashkëpunim edhe me autoritetet drejtuese.

## ANALIZA SWOT

Pikat e forta të brendshme potenciale	Pikat e dobëta të brendshme potenciale
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tradita dhe përvoja e gjate e fakultetit, për një periudhe 50 vjeçare</li> <li>• Programe akademike bashkëkohore. Kurrikula të veçanta në përputhje me prioritetet e zhvillimit të Rajonit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Preferencë jo e lartë nga maturantët për degët e Fakultetit të Bujqësisë.</li> <li>• Cilësia e ulët e studenteve në hyrje dhe në përfundim të studimeve.</li> <li>• Nevojë për përfshirje më të madhe dhe ndërgjegjësim të studentëve për rolin që</li> </ul>

- Shkalla e lartë e kualifikimit të stafit akademik të brendshëm të fakultetit dhe atij mbështetës.
- Infrastruktura e përshtatshme për zhvillimin e mësimin (auditorë dhe laboratorë) dhe të veprimtarive të tjera, dhe internet 24 ore.
- Fakulteti i Bujqësisë është i vetmi në gjithë rajonin e jugut dhe juglindje të vendit.
- Zhvillimi i tre programeve Master, pasi i plotësojmë kushtet me bazën materiale mësimore si dhe me stafin e kualifikuar që kemi në Fakultet në bashkëpunim dhe me Universitetin Bujqësor të Tiranës.
- Lidhjet e ngushta me AREB Korçë, AKU, QTTB, me ndërmarrjet e agrourbimit, etj për zhvillimin dhe realizimin e praktikave profesionale dhe punësimin e mjaft studentëve të diplomuar; në këtë kuadër janë punësuar një numër i mirë studentësh që kanë mbaruar Fakultetin tonë.
- Lidhjet e ngushta të Fakultetit tonë me fakultetet homologe brenda dhe jashtë vendit.
- Paraqitja e Fakultetit të Bujqësisë, si qendër e rëndësishme kërkimore-shkencore, si një qendër kualifikimi e transmetimit të njohurive bashkëkohore jo vetëm në Qarkun e Korçës, por edhe në rajonin jug-lindor të Shqipërisë si i vetmi institucion mësimor, Kërkimor dhe shkencor në fushën e bujqësisë.
- Botimet e stafit mësimdhënës dhe të kolegëve nga fakultet homologe të universiteteve të vendit dhe të huaj.
- Pjesëmarrja e stafit të Fakultetit në veprimtari lokale ose kombëtare.
- Përfshirja e stafit në projekte dhe trajnime të ndryshme.
- Ekzistenca e EDE-së dhe baza materiale e saj favorizon punën kërkimore-shkencore, kryerjen e praktikave profesionale, por njëkohësisht ajo shërben edhe si bazë prodhuese.
- Organizimi i mirë i praktikave profesionale dhe i stazhit të studentëve tanë.
- Literatura e siguruar për stafin mësimdhënës dhe prezenca e bibliotekës të fakultetit dhe e universitetit.

- luajnë në sigurimin e cilësisë së veprimtarisë akademike.
- Infrastruktura jo e plote e EDE-se
- Rritja e bashkëpunimit me institucione të tjera, palë të interesit
- Rritja e rolit të këshillimit të karrierës në secilin program.
- Mos shfrytëzimi i literaturës ekzistuese në bibliotekë nga studentët në shkallën e duhur. Orientim më i mirë nga ana e pedagogëve.
- Digjitalizimi i materialeve të bibliotekave të Fakulteteve.

<p><b>Si u përdorën pikat e forta në ngritjen e strategjive e uljes së rreziqeve dhe përmirësimin të pikave të dobëta</b></p>	<p><b>Cilat janë strategjitë e mundshme në përmirësimin e pikave të dobëta të evidentuara. (sugjerime)</b></p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Bashkëpunimi kombëtar e ndërkombëtar dhe pjesëmarrja në projekte te ndryshme.</i></li> <li>• <i>Bashkëpunimi me universitete të tjera të profilit Bujqësor si dhe me Institucionet e tjera publike dhe private.</i></li> </ul>	
<p><b>Mundësitë e jashtme potenciale</b></p>	<p><b>Rreziqet e jashtme potenciale</b></p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ngritja e një qendre Kërkimore shkencore pranë EDE-se.</li> <li>• Shanse për rritjen e bashkëpunimit të Fakultetit me komunitetin e fermerëve dhe biznesin rajonal.</li> <li>• Ngritja e një njësie të re (departament ose qendre kërkimore) dhe ngritja e mini-linjave të teknologjive të produkteve bujqësore.</li> <li>• Kthimi i fakultetit ne një qendër trajnimi për të gjithë specialistët e bujqësisë.</li> <li>• Mundësia e dhënies të mbështetjes financiare nga organizma qeveritare për studentet me të mire ne fakultet.</li> <li>• Përmirësimi dhe standardizimi i CV dhe syllabuseve.</li> <li>• Përmirësimi i vazhdueshëm i kualifikimit të stafit të pedagoqeve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i ulët i studentëve që duan te frekuentojne programet e studimit të Fakultetin të Bujqësisë.</li> <li>- Kërkesa aktuale jo e larte nga tregu i punës.</li> <li>- Tërheqja e një numri të konsiderueshëm studentesh të rajonit nga universitetet private si dhe hapja e degëve të reja ne fakultetet e tjera brenda universitetit dhe jashtë tij.</li> </ul>
<p><b>Sa ndikim kanë mundësitë e jashtme potenciale në rritjen e cilësisë dhe përmirësimin e dobësive</b></p>	<p><b>Strategji të shmangies së rreziqeve të jashtme potenciale</b></p>
	<p>Për të ulur rreziqet e jashtme ne propozojme këto strategji:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <i>Dhenien e Bursave per studentet qe frekuentojne deget ne Fakultetin e Bujqesise.</i></li> <li>2. <i>Krijimi i nje databaze për punësimin e studentëve të diplomuar në vite ne Fakultetin</i></li> </ol>

*e Bujqësisë.*

*3.Promovimi i Fakultetit të Bujqësisë, duke qene se eshte i baza e krijimit te Universitetit “Fan S. NOLI”. Korçë.*

## **FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË**

### ***Konstatime, problematika dhe rekomandime:***

1. Për sigurimin e cilësisë në FEF, tregohet kujdes i veçantë. Ai, ashtu si në gjithë strukturat e UNIKO-së konsiderohet përparësi për secilin punonjës, ndiqet me kujdes nga strukturat drejtuese dhe monitorohet në mënyrë permanente nga NJSBC. Përvoja e derisotme dëshmon për nevojën e një kontrolli të tillë, për domosdoshmërinë e një njësie të posaçme monitorimi, që orienton institucionin drejt plotësimit të standardeve të cilësisë dhe shërben si forcë shtytëse për një performancë në rritje në nivel institucioni dhe për çdo individ. Feedback –u i marrë nga kontakti me ish-studentët e tij, Alumni, të cilët janë mësues në shërbim dhe zhvillojnë pranë Qendrës së Formimit të Vazhduar trajnime të përvitshme në sesione të ndryshme gjatë vitit në kuadër të zhvillimit profesional, sipas akteve ligjore në fuqi, janë një element i rëndësishëm që mbahet parasysh lidhur me cilësinë e programeve që ofron fakulteti.
2. Feedback –u i marrë nga kontakti me ish-studentët e FEF, Alumni, të cilët janë mësues në shërbim dhe zhvillojnë pranë Qendrës së Formimit të Vazhduar trajnime të përvitshme në sesione të ndryshme gjatë vitit në kuadër të zhvillimit profesional, sipas akteve ligjore në fuqi, janë një element i rëndësishëm që mbahet parasysh lidhur me cilësinë e programeve që ofron fakulteti.
3. GVB vëren se FEF ka krijuar lidhje të qëndrueshme me një mjaft institucione të administratës publike që janë palë interesi për programet që ofron për të lehtësuar procesin e praktikave profesionale të studentëve, si edhe punësimin e ardhshëm të tyre. Kë këtë kuadër, UNIKO zhvillon çdo vit edhe Panairin e Punës, pjesë e të cilit është dhe FEF, për të lehtësuar kontaktin e studentëve me kompani nga më të rëndësishmet në Shqipëri, me synim punësimin e mundshëm të studentëve në to. Edhe periodha kohore e zhvillimit të Panairit të Punës, përkon pikërisht me fundin e vitit akademik për të krijuar sa më shumë mundësi për studentët në prag diplomimi.

## ANALIZA SWOT

Pikat e forta të brendshme potenciale	Pikat e dobëta të brendshme potenciale
<p><b>Vizioni dhe Misioni:</b></p> <p>FEF ka një vizion dhe mision të qartë dhe të mirëpërcaktuar, duke treguar drejtimin e qartë të institucionit.</p> <p><b>Përshtatje me Standartet Akadematike:</b></p> <p>Programet e studimit përditësohen dhe respektojnë standardet akademike, duke garantuar një bazë cilësore për përgatitjen e studentëve.</p> <p><b>Mbështetje nga Ekspertiza:</b></p> <p>Programet janë ndërtuar duke marrë mbështetje dhe ekspertizë nga përvoja më e mirë vendase dhe e huaj, duke siguruar një perspektivë bashkëkohore.</p> <p><b>Personeli Akademik:</b></p> <p>Personeli akademik me tituj dhe përvojë domethënëse është pikë mbështetjeje e fortë, duke siguruar cilësi në mësimdhënie dhe hartim programi.</p> <p><b>Infrastrukturë dhe Traditë:</b></p> <p>Infrastruktura funksionale dhe tradita e fituar ndihmojnë në krijimin e një mjedisi pozitiv të nxënies për studentët.</p>	<p><b>Numri i Studentëve:</b></p> <p>Numri i studentëve mund të jetë jo në nivelet e kërkuara, duke sugjeruar nevojën për strategji për rritjen e aplikimeve.</p> <p><b>Koordinimi i Fushave të Kërkimit:</b></p> <p>Nevoja për më shumë koordinim dhe prioritet në fushat e kërkimit midis stafit akademik dhe studentëve.</p> <p><b>Përfshirja dhe Ndërgjegjësimi i Studentëve:</b></p> <p>Nevoja për përfshirje dhe ndërgjegjësim të studentëve për rolin e tyre në sigurimin e cilësisë së veprimtarisë akademike.</p>

<p><b>Te tjera:</b>  <b>Rritja e cilësisë së kandidatëve që aplikojnë për programet e ciklit të parë.</b>  <b>Transmetimi tek studentët i një informacioni cilësor e bashkëkohor në të gjitha disiplinat mësimore e lëndët me karakter teorik e praktik, duke synuar arritjen e kompetencave profesionale e personale, me qëllim përgatitjen e studentëve cilësorë, të aftë që të analizojnë dhe konkludojnë në mënyrë të pavarur, të debatojnë e marrin vendime të sakta, të orientohen shpejt përballë tërësisë së informacioneve dhe specifikave të sektorëve e degëve ku ata specializohen.</b>  <b>Infrastrukturë funksionale që përpiqet drejt trendeve bashkëkohore. Bashkëpunim i institucionalizuar me institucione homologe dhe institucione të tjera bashkëpunuese për të realizuar objektivat për kërkimin, shkëmbimin e eksperiencave dhe punësimin e të diplomuarve.</b>  <b>Hartimi dhe funksionimi i një dokumentacioni ligjor dhe pedagogjik në nivel institucional dhe fakulteti, si tregues që dëshmon për një veprimtari të institucionalizuar, të strukturuar dhe të standardizuar</b></p>	
<p><b>Si u përdorën pikat e forta në ngritjen e strategjive e uljes së rreziqeve dhe përmirësimin të pikave të dobëta</b></p>	<p><b>Cilat janë strategjitë e mundshme në përmirësimin e pikave të dobëta të evidentuara. (sugjerime)</b></p>
<p><b>Kthimi i realizimit të konferencave studentore periodike , si një mundësi e mirë. Nxitja e mobiliteteve mësimdhënëse dhe trajnuese për stafin akademik dhe studentët. Promovimi i përvojave më të mira në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor përmes veprimtarive me ekspertë dhe përvoja ndër- kombëtare.</b>  <b>Organizimi i veprimtarive shkencore të mirorganizuara në formën e konferencave, seminareve shkencore perodike; ëorkshopeve, shkëmbim stafi etj;</b></p>	<p><b>Të këmbëngulet në zbatimin e një strategjie për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të fushave të kërkimit, të identifikuara si prioritete.</b>  <b>Konsolidimi i programeve ekzistuese në ciklin BACHELOR dhe MASTER duke përmirësuar kurrikulën ekzistuese dhe njësuar atë me kurrikulat e universiteteve të tjera brenda vendit dhe në rajon, me gjithë përpjekjet, mbetet ende sfidë;</b></p>
<p><b>Mundësitë e jashtme potenciale</b></p>	<p><b>Rreziqet e jashtme potenciale</b></p>

<p><b>Eksperiencia e fituar rrit mundësitë për të aplikuar dhe për t'u bërë pjesë e projekteve të reja duke përfshirë gjithnjë e më shumë studentët.</b></p> <p><b>FEF gëzon një imazh pozitiv dhe të mirë në publik të cilin synon ta përforcojë dhe të ndërtojë mbi të të ardhmen e tij si një fakultet tërheqës për studentët</b></p> <p><b>Mundësi për ndjekjen e karrierës studentore edhe pas futjes në shërbim nëpërmjet takimeve, trajnimeve që zhvillohen në QFV dhe gjurmimi nga QKA.</b></p>	<p><b>Unifikimi i kurrikulave të programeve të njëjta ose të përafërta me fakultete të tjera</b></p> <p><b>Domosdoshmëria për diversifikimin e burimeve të financimit</b></p> <p><b>Pengesa të tjera nuk konstatohen</b></p>
---	--

## **FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS DHE SHKENCAVE HUMANE**

**Nuk kemi të dhëna për këtë fakultet pasi nuk është dorëzuar RVB e fakultetit**

**Spektori i Kurrikulës Vlerësimit Institucional dhe Alumni  
Evis Kapurani**

